

## KONTRATË SHITJE KUOTASH

Nënshkruar me datë 02/06/2020

*Ndërmjet*

- **Z. Bledar Shpëtim Palloshi**, shtetas shqiptar, lindur më 27.07.1984 mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. 031858510 dhe numër personal I40727084D, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, referuar këtu e në vijim (në vijim "Shitësi"), ose "Pala" ose bashkarisht "Palët";

*dhe*

- **Z. Eno Sandër Kepi**, shtetas shqiptar, lindur më 04.08.1989 mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. 035578233 dhe numër personal I90804108Q, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, referuar këtu e në vijim (në vijim "Blerësi"), ose "Pala" ose bashkarisht "Palët";

të gjitha palët zotërojnë aftësi të plotë për të vepruar, me vullnet të lirë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, pranojnë të lidhin dhe në fakt lidhin këtë kontratë për shitjen e kuotave sipas kushteve të mëposhtme.

*Duke pasur parasysh se*

- **Z. Bledar Shpëtim Palloshi** zotëron 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë "BPO" sh.p.k e regjistruar në Regjistrin Tregtar (QKB) me numër unik identifikimi (NUIS) L72526403I (në vijim "Shoqëria");
- **Z. Eno Sandër Kepi** shpreh interesin e tij për blerjen e 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë "BPO" sh.p.k në zotërim të Z. Bledar Shpëtim Palloshi.

*Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, palët bien dakortë për sa më poshtë vijon:*

### NENI 1

Kushtet paraprake të sipërpëmendura janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

### NENI 2

Shitësi i shet me të drejta pronësie të plota Blerësit, i cili siç është përcaktuar më sipër pranon dhe blen 100% të kapitalit themeltar, me çmimin e barabartë me 2,000,000 (dymilion) LEKË, shumë që pala blerëse deklaron se i ka paguar palës shitëse e cila pranon se i ka marrë nga pala blerëse më parë.

### NENI 3

Z. Bledar Shpëtim Palloshi deklaron se këto kuota janë në pronësi të tij të plotë dhe ekskluzive, nuk janë objekt çështje gjyqësore në zhvillim e sipër dhe gjithashtu janë të lira nga çfarëdolloj pengu apo barre apo detyrimi ndaj të tretëve.

### NENI 4

Me anë të kësaj kontrate Shitësi humbet të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me pjesët e shitura, ndërsa Blerësi bëhet pronar i pjesëve të blera duke fituar njëkohësisht të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me to.

### NENI 5

Shpenzimet në lidhje dhe që rrjedhin nga kjo kontratë janë në ngarkim të palës blerëse.

### NENI 6

Kjo kontratë do të detyrojë palët dhe do të jetë e vlefshme midis tyre, ashtu edhe për trashëgimtarët e tyre.

### NENI 7

Kjo kontratë përfshin tërësisht marrëdhëniet midis palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme që janë të lidhura me këtë objekt. Ndryshime të mundëshme ose kufizime kësaj kontrate mund t'i bëhen vetëm me shkrim, të nënshkruhen nga të gjitha palët dhe t'i bashkëngjiten asaj.

### NENI 8

Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje me të njëjtën vlerë ligjore, të gjitha të nëshkruara nga palët dhe rregullohet nga Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

Të gjitha mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate së pari do të jenë objekt i një tentative për një zgjidhje miqësore. Në rast të kundërt, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për të zgjidhur mosmarrëveshjet midis Palëve.

### SHITËSI

Z. Bledar Shpëtim Palloshi



### BLERËSI

Z. Eno Sandër Kepi

ENO KEPI  
